

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TIRANE

(Final)

RAPORTI I VNM

PROJEKTI:
“SHKOLLA 9-VJECARE NDROQ”



I. HYRJE	4
II. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV	4
2.1 Politika	4
2.2 Baza Legjislative.....	5
2.3 Kuadri Institucional.....	7
2.4 Te Drejtat e Qytetareve.....	8
III. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	9
IV .PERSHKRIM I ZONES KU DO NDERTOHET OBJEKTI.....	13
4.1 Probleme Mjedisore	13
4.2 Karakteristikat Klimatike	14
Temparatura e ajrit	14
Mjegulla.....	14
Rreshjet atmosferike.....	14
Lageshtia e ajrit	14
Era	14
Stuhite	15
4.3 Flora dhe Fauna	15
Gjitarët:	15
Zogjte:	15
Zvarraniket:.....	15
Amfibet:	15
4.4 Objektet arkeologjike dhe kulturore	16
4.5 Cilesia e ajrit dhe normat e tij	16
4.6 Zhurmat	18
4.7 Gjeologjia dhe Hidrogeologjia	19
V. NDIKIMET NE MJEDIS GJATE KOHES SE FUNKSIONIMIT	19
5.1 Analiza e ndikimeve ne mjedis	19
5.2 Cilesia e ajrit	19
5.3 Sheshi i Ndertimit	19
5.4 Mbetjet gjate ndertimit.....	19
5.5 Matricat permbledhese te ndikimit ne mjedis.....	20
5.6 Klima	20
5.7 Flora dhe Fauna	20
5.8 Drenazhimi	20
5.9 Trashegimia Arkeologjike dhe kulturore	20
VI. MASAT DHE PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	20
6.1 Ndotja e Ajrit dhe Zhurmat	21
6.2 Biodiversiteti.....	21

6.3 Shfrytezimi i Tokes	21
6.4 Trashegimia Arkeologjike dhe kulturore.....	21
VII. KONKLUZIONE	21

I. HYRJE

Ky studim i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ka të bëjë me objektin "Shkolla 9-vjeçare Ndroq".

Vendndodhja: Qendër Ndroq, Njësia Administrative Ndroq.

Përshkrim: Shkolla 9 - vjeçare Ndroq është ndërtuar në vitin 1968 dhe rikonstruktuar në vitin 2010. Godina e shkollës është objekt dykatësh dhe mbulesa është e tipit çati. Sipërfaqja e përgjithshme e territorit është 1090 m², kurse sipërfaqe e gjurmës 316 m².

Kapaciteti: Në total frekuentojnë mësimin rreth 220 nxënës, të cilët e zhvillojnë mësimin në 7 klasa, të cilat ofrojnë kushtet për mësim ndërkohë një pjesë tjetër e nxënësve zhvillojnë mësimin në shkollën e mesme e cila ndodhet afër shkollës 9- vjeçare. Gjithashtu në këtë shkollë zhvillojnë mësimin parashkollor rreth 50 fëmijë të ndarë në dy grupe. Mësimi zhvillohet me një turn.

Ky vleresim mjedisor do të jap nje informacion te permbledhur qe do te realizohen ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis si dhe masat mbrojtese qe do te merren gjate ndertimit.

Vleresimi mjedisor i territorit te marre ne studim perqendrohet ne evidentimin e parametrave fiziko - natyror, ne evidentimin e elementeve qe shfaqin rëndesi te veçante natyrore per ruajtjen si dhe te vleresimit te ndikimit ne mjedis te elementeve te rinj qe do te sjelle ky objekt ne drejtim te harmonizimit dhe sistemimit urbanistik dhe estetik te zones ne fjale me qellim arritjen e parametrave bashkohore, po ashtu vleresimi mjedisor parashikon edhe veçoritë e rajonit ku do te behet ky ndertim, historiku i tij dhe tendencat qe shfaq kjo zone per thithjen e ndertimeve te metejshme.

Ky vleresim tenton te ndihmoje sa me shume te jete e mundur vendim marresit me ane te dhenies se informacioneve te mjaftueshme mjedisore, ç'ka kontribuon edhe per lehtesimin e ndjekjes dhe monitorimit te aktivitetit te ndertimit dhe funksionimit nga investitori dhe organet pergjegjese.

Raporti i VNM mbeshetetet mbi projektin teknik dhe integron ne te masat zbutese apo planin e menaxhimit mjedisor.

Ky studim perfshin nje pershkrim te objektit dhe ambjentit ku ai eshte vendosur, pershkon mjediset rrethuese dhe ekosistemin te cilit i perket. Ai identifikon ndikimet me te rëndesishme negative, ndikimet pozitive, jep masat zbutese dhe ato kompensuese mjedisore.

II. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2.1 POLITIKA

Gjate dhjete-vjecarit te fundit qeveria ka filluar zhvillimin e nje kuadri per te ndryshuar degradimin mjedisor i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve te meparshme gjate sundimit komunist, i cili ka anashkaluar mbrojtjen e mjedisit pothuajse plotesisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit i cili kerkon nga Republika qe:

"te mirembaje nje mjedis te pershtatshem te shendetshem dhe ekologjik per brezat e sotem dhe te ardhshem".

Per me teper, Legjislacioni kerkon qe burimet natyrore duhet te shfrytezohen racionalisht ne perputhje me principe te bazuara.1

Politikat e perpiluar per mjedisin ne ditet e sotme jane pasqyruar ne ligjin e vitit 2002.

Kapitulli II "Politikat Mjedisore" percakton politiken e qeverise per:

Politika shteterore mjedisore – percakton pozicionin e mjedisit ne legjislacion, vendin e strategjive te sektoreve kombetare dhe planet lokale si pjese e politikës mjedisore dhe percakton organizmat te cilet do te administrojne keto politika.

Programet dhe strategjite mjedisore – percakton Planin e Veprimit Kombetar te Mjedisit (PVKM) i cili duhet te prodhoje çdo dhjete vjet nje raport mjedisor ne zbatimin e PVKM per Keshillin e Ministrave

Planet lokale mjedisore – kerkojne nga qeverisja lokale te zhvillojne Planet lokale te Veprimit te Mjedisit (PLVM) duke perdorur organizmat kombetare per te ofruar te dhena dhe mbeshtetje teknike, per qeverite lokale te lidhen me publikun, OJQ dhe biznesin per zhvillimin e planeve dhe Kryetaret e Bashkive te raportojne ne Keshillin e Rretheve per zbatimin e planeve ne fund te çdo viti .Qeveria Shqiptare ka publikuar Planin e pare Kombetar te Veprimit te Mjedisit (PKVM) ne vitin 1993, i cili percakton qellimet mjedisore qe synohen per nje plan veprimi per vendin. Struktura e pare Mjedisore eshte ngritur ne vitin 1994 dhe nje strukture e dyte eshte ngritur ne vitin 1998. Raporti i Struktures Mjedisore per 1999-2000 eshte realizuar por nuk eshte botuar – megjithese mendohet qe do te publikohet se shpejti. Vonesat jane shkaktuar ne nivel institucional nga Agjensia Kombetare e Mjedisit ne Ministrine e Mjedisit¹. Dorezimi i varfer i raportit vjetor ne implementimin e PVKA eshte si rezultat i pengesave te burimeve te ndryshimeve institucionale qe kane ndodhur ne tre vitet e fundit.

2.2 BAZA LEGJISLATIVE

Legjislacioni qe drejton mbrojtjen e mjedisit eshte fuqizuar relativisht me shpejtesi ne Shqiperi. Ligji i pare per Mbrojtjen e Mjedisit doli ne vitin 1993 dhe u amendua ne vitin 1998 dhe 2001. Ky ligj percakton ne Kapitullin II (Vleresimi i Ndikimeve te Mjedisit) Neni 7 se:

"te gjithë aktivitetet natyrale dhe te personave legale, vendas ose te huaj, te cilet ushtrojne aktivitetin e tyre ne territorin e Republikës se Shqiperise, do te jene subjekte te vleresimeve te ndikimeve te mjedisit".

Neni 8 jep ne terma te pergjithshme llojet e aktiviteve per te cilat autoritetet do te kerkojne Vleresimet e Ndikimeve te Mjedisit (VNM). Neni 9 specifikon pergjegjesine e autoritetit qe do te jete Komitetit i Mbrojtjes se Mjedisit, dhe aktivitetet e tij rajonale. Ligji nuk specifikon fazat individuale te procesit te VNM.

Me vone doli Ligji Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit. Ky shfuqizoi te gjithë ligjet e meparshme per mbrojtjen e mjedisit dhe ka ne princip dhjete fusha kryesore te drejtimit:

- Politikat Mjedisore
- Shfrytezimi dhe Mbrojtja e Perberesve te Mjedisit
- Vleresimi i Ndikimeve te Mjedisit
- Lejet per Aktivitetet te cilat ndikojne ne Mjedis
- Ndalimi dhe Kufizimi i Ndotjes se Mjedisit
- Monitorimin dhe te Dhenat
- Kontrollin Mjedisor
- Detyrat e Organizmave Shteterore per Mjedisin
- Rolin e Publikut
- Sanksionet

Ligji Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit i dates 5/09/2002 percakton se mbrojtja e mjedisit eshte e detyrueshme per te gjithë personat, juridike dhe individuale te cilet ushtrojne aktivitet ne Shqiperi. Neni 34 kerkon nga çdo person ose organizate te marrin lejen nga organizmat pergjegjes (Ministria e Mjedisit) ne menyre qe te zhvilloje çdo pune te veçante ne Shqiperi e cila ndikon ne mjedis. Qe te merret kjo leje duhet te pergatitet nje vleresim per ndikimet e mjedisit.

Deri ne kohet e fundit nuk ka pasur proçese legale te percaktuara per zhvillimin e VNM. Nje -ligj per Vleresimet e Ndikimeve te Mjedisit u pergatit ne vitin 1995, por deri me sot nuk eshte pershtatur nga Qeveria e Shqiperise. Megjithetete ky ligj eshte perdorur me raste si nje udhezues ne procedurat e VNM ne Shqiperi. Megjithetete Ligji Nr. 8990 per Vleresimet e Ndikimeve te Mjedisit u aprovua me 23/01/2003. Ky ligj percakton te gjithë proçedurat per pergatitjen dhe paraqitjen per aprovim te VNA ne Shqiperi. Ligji gjithashtu percakton se çfare niveli eshte VNM qe duhet te ndiqet per lloje te ndryshme zhvillimi.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis Nr . 8990, date 23.01.2003 synon qe te siguroje:

- a) Vleresimin e pergjithshem, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore te projekteve ose veprimtarive qe kerkojne te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis;
- b) Nje proces vleresimi te hapur dhe te administruar me paanshmeri, nepermjet pjesemarrjes se organeve qendrore e vendore, te publikut, te organizatave jofitimpruese per mjedisin, te propozuesit te projektit dhe te personave fizike dhe juridike, te specializuar ne kete fushe.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis kerkon qe informacionet e meposhtme te perfshihen ne SNM:

- Qellimin e projektit.
- Pershkrimin e tij te hollesishem.
- Te dhena per mjedisin ekzistues te zones ku zbatohet projekti dhe ne afersi te saj.
- Pershkrimin e hollesishem te te gjitha instalimeve, qe bejne pjese ne projekt ose qe do te perdoren gjate zbatimit te tij.
- Planin e ndertimit dhe afatet e zbatimit te tij.
- Pershkrimin e veprave inxhinierike, qe ndertohen ose zgjerohen dhe te veprave te domosdoshme per zbatimin e projektit.
- Ndikimet e mundshme ne mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin dhe zbutjen e tyre.
- Programin e monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit.
- Perputhjen e projektit me planet e rregullimit te teritorit dhe me planet e zhvillimit ekonomik te zones ku do te zbatohet projekti.
- Permbledhjen e keshillimeve me organet e qeverisjes vendore, publikun e organizatat jofitimpruese per mjedisin dhe te mendimeve te tyre.
- Masat rehabilituese, ne rast ndotjeje dhe demtimi te mjedisit, si dhe koston e tyre.
- Kopjen e licences se personit fizik ose juridik, qe ka pergatitur raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Nje seri me ligje te tjera jane duke u pergatitur per te mbeshtetur Ligjin Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit i dates 5/09/2002 duke perfshire:

- Kontrollin e ndotjes
- Mbrojtja e banoreve dhe e biodiversitetit
- Menaxhimi i mbetjeve
- Vendosja e standarteve mjedisore
- Kerkesat per monitorim

Ekzistojne legjislacione te cilat ndikojne ne mjedis siç jane:

Ligji Nr 8093 – Amenduar nga ligjet 8375, 8605,dhe 8736, rregullon shfrytezimin e zhavorreve nga shtratet e lumenjve, perrenjve, etj.

Ligji Nr 8561 – Per Shpronësimin dhe Marrjen e Perkohshme per Interesat Publike 12/22/1999 - percakton procedurat per shpronësimin e tokes dhe nivelet e kompensimit per interesa publike.

Ligji Nr. 7623 - Per Pyjet dhe Policine e Pyjeve ne vitin 1992 dhe siç eshte amenduar (Nenet 63 & 64) nga Ligji Nr. 7839 – percaktojnë shfrytëzimin e pyjeve.

Ne raste ekstreme publiku ka te drejte te kerkoje referendume kombetare ose te pjeseshme per çeshtje te vecanta te mjedisit sipas Ligjit Nr. 7866 ne Referendumin te dates 6/10/1994.

Ligji 8561, 22/12/1999, percakton qe personat private kane te drejta ne respekt te pronësisë private qe ata disponojne dhe se e drejta e pronësisë publike ushtrohet vetem per interesa publike dhe nuk mund te realizohet dhe mbrohet ne menyre tjeter. Ai percakton me tej se te drejttat e pronareve jane te mbrojtura dhe se te drejttat e te tretteve te pronave te tyre jane zhvlerësuar si rezultat i shpronësimit.

Ne rastet e shpronësimeve per interesa publike nga ana e shtetit, Ministri kompetent (ne kete rast Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit) cakton nje komision special qe te administroje ne menyre te pershtatshme shpronësimet dhe te vendose vleren e pronësive per t'u shpronësuar. Vendimet e shpronësimit nga ana e Ministrimit i paraqiten KM per vendim dhe pronaret e pronave kane te drejte te apelojne, por apelimi nuk duhet te vonoje shpronësimin.

2.3 KUADRI INSTITUCIONAL

Agjensia Kombetare e Mjedisit (AKM) u krijua ne vitin 19981. Ne vitin 2002, ligji i ri percaktoi se Ministria e Mjedisit, e cila duhet te ofroje nje kontroll te centralizuar te mjedisit ne emer te Ministrise se Mjedisit (Neni 67).

Neni 64 percakton qe Ministria e Mjedisit mbeshtetet nga:

- Agjensite Rajonale te Mjedisit
- Inspektoriat i Mjedisit
- Organizmat Mjedisore (te cilat jane institucione qe veprojne nen Ministrine e Mjedisit siç eshte Instituti i Mjedisit i cili eshte pergjegjes per monitorime)
- Organizmat qeveritare lokale dhe organizma te tjere nder-ministrare siç percaktohen kohe mbas kohe.

Drafti i politikës mjedisore te Ministrise se Mjedisit, percakton kufizime per normat e ndotjes dhe koordinon me agjensite ekzekutive si jane implementuar politikat mjedisore ne terren. Ashtu siç ndodh ne vende me nivel te larte varferie, mbrojtja e mjedisit ka nje vleresim te ulet ne kuptimin buxhetor. Rezultati eshte se zbatimi dhe detyrimi i politikës mjedisore eshte i dobet si rezultat i mungeses se burimeve te papershtatshme nje rezore, paisjeve dhe lehtesirave.

Financimi i Ministrise se Mjedisit supozohet te vije pjeserisht nga taksat per licensat dhe nga burime te tjera te fondeve siç eshte percaktuar ne Ligjin NR. 8934 te Mbrojtjes te Mjedisit i dates 5/0/20022.

Si shtese e detyrave te vendosura direkt nga Ministria e Mjedisit do te dale e qarte se nje numer i organizatave te tjera shtetërore kane nje rol te rendesishem ne monitorimin dhe mbrojtjen e flores dhe te faunes duke perfshire:

- Muzeun Kombetar te Shkencave Natyrore
- Instituti i Kerkimeve Biologjike
- Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave pergjegjese per kontrollin e pyjeve

Megjithë kete mori institutesh pergjegjese per monitorimin, aktualisht jane realizuar pak studime ne kete fushe ne gjendjen e flores dhe te faunes ne Shqiperi, qe vjen kryesisht si rezultat i kufizimeve buxhetore.

Institucione te tjera qe kane nje rol te rendesishem ne mjedis jane:

- Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit
- Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes
- Ministria e Shendetesise dhe Instituti i Shendetit Publik – pergjegjes per monitorimin e cilesise se ujit te pishem dhe cilesise se ajrit
- Instituti Hidro-Meteorologjik – mbledhjen e te dhenave metereologjike dhe eshte pergjegjes per monitorimin e cilesise se ujit dhe te ajrit
- Keshilli Kombetar i Rregullimit te Territorit (KKRrT) – pergjegjes per leshimin e lejeve te ndertimit me kushte te cilat perfshijne kerkesa per mbrojtjen e mjedisit.

2.4 TE DREJTAT E QYTETAREVE

Ligji Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit i dates 5/09/2002 percakton rolin dhe te drejtat e publikut ne çeshtjet mjedisore. Kapitulli X Roli i Publikut perfshin ceshtjet qe vijojne:

- Te drejtat e publikut per te marre te dhena mjedisore
- Rolin e OJQ per mbrojtjen e mjedisit
- Pjesemarrja e publikut ne marrjen e vendimeve ne çeshtjet mjedisore
- Rolin e bizneseve dhe organizatave te tjera profesionale ne mbrojtjen e mjedisit
- Te drejtat per personat private per te kerkuar mbrojtjen e mjedisit nga organizmat e autorizuar dhe te drejten te çoje ne gjyq organizatat dhe personat te cilat shkaktojne ose rrezikojne te shkaktojne deme ne mjedis.

Gjate dhjete-vjecarit te fundit qeveria ka filluar zhvillimin e nje kuadri per te ndryshuar degradimin mjedisor i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve te meparshme gjate sundimit komunist, i cili ka anashkaluar mbrojtjen e mjedisit pothuajse plotesisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit i cili kerkon nga Republika qe:

“te mirembaje nje mjedis te pershtatshem te shendetshem dhe ekologjik per brezat e sotem dhe te ardhshem”.

Legjislacioni qe drejton mbrojtjen e mjedisit eshte fuqizuar relativisht me shpejtesi ne Shqiperi. Ligji i pare per Mbrojtjen e Mjedisit doli ne vitin 1993 dhe u amendua ne vitin 1998 dhe 2001. Ky ligj percakton ne Kapitullin II (Vleresimi i Ndikimeve te Mjedisit) Neni 7 se:

“te gjithë aktivitetet natyrale dhe te personave legale, vendas ose te huaj, te cilet ushtrojne aktivitetin e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise, do te jene subjekte te vleresimeve te ndikimeve te mjedisit”.

Me vone doli Ligji Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit. Ky shfuqizoi te gjithë ligjet e meparshme per mbrojtjen e mjedisit dhe ka ne princip dhjete fusha kryesore te drejtimt:


- Politikat Mjedisore
- Shfrytezimi dhe Mbrojtja e Perberesve te Mjedisit
- Vleresimi i Ndikimeve te Mjedisit
- Lejet per Aktivitetet te cilat ndikojne ne Mjedis
- Ndalimi dhe Kufizimi i Ndotjes se Mjedisit
- Monitorimin dhe te Dhenat
- Kontrollin Mjedisor
- Detyrat e Organizmave Shteterore per Mjedisin

- Rolin e Publikut
- Sanksionet

Ligji Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit i dates 5/09/2002 percakton se mbrojtja e mjedisit eshte e detyrueshme per te gjithë personat, juridike dhe individuale te cilat ushtrojne aktivitet ne Shqiperi. Neni 34 kerkon nga çdo person ose organizate te marrin lejen nga organizmat pergjegjes (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave) ne menyre qe te zhvilloj çdo pune te vecante ne Shqiperi e cila ndikon ne mjedis. Qe te merret kjo leje duhet te pergatitet nje vleresim per ndikimet e mjedisit.

III. PERSHKRIMI I PROJEKTIT


Vendodhja e shkolles




Gen-Plan i shkolles

Planimetrite e gjendjes ekzistuese:

Plani I katit perdhe



Plani I katit te pare



Fotografi nga gjendja ekzistuese e shkolles:



Vlerësimi fizik i objektit: Megjithëse shkolla është e mirëmbajtur, vërehen probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen më tepër. Nga një vlerësim paraprak rezulton se:

- Në anën perëndimore të shkollës, vërehet një çedim i cili ka shkaktuar plasaritje të dukshme në strukturën e saj. Në klasat në të cilat kalon kjo plasaritje aktualisht është ndërprerë mësimi për arsye sigurie.
- Ka nevojë për sistemi të ujërave të shiut, duke qenë të pasistemuara ato depërtojnë në ambientet e brendshme të shkollës duke shkaktuar lagështi të dukshme në katin e përdhe të saj.
- Ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit në ambientet e jashtme sportive.
- Tavanit i katit të parë është i varur dhe jashtë përdorimit, në disa klasa për arsye sigurie nuk zhvillohet mësim.
- Nyjet sanitare rrjedhin dhe japin lagështi në klasa, pajisjet hidrosanitare janë pjesërisht jashtë funksionit.
- Mungon sistemi i ngrohjes, ngrohja pjesërisht me soba druri dhe rezistencë.
- Sistemi elektrik duhet të rishikohet pasi nuk mban ngarkesë.
- Nuk ka sistem të MNZ-së.
- Ka dëmtime të pllakave të dyshemesë në disa nga ambientet e shkollës.
- Dyert kanë nevojë për riparime dhe zëvendësime si dhe pjesërisht dritaret.
- Ka nevojë për rrethim të terreneve sportive si dhe për riparime të tyre.
- Shkolla nuk ka palestër.

Shkolla 9 - vjeçare Ndroq propozohet për rikonstruksion të plote të godinës, vlerësimin e plasaritjes në strukturë dhe trajtimin e saj, riparimin e tavanit të katit të parë, sistemimin e ujërave të shiut, zëvendësim të pajisjeve sanitare, pllakave, dyerve dhe dritareve të dëmtuara, riorganizim dhe gjelbërim të ambientit të jashtëm dhe terreneve sportive. Gjithashtu propozohet ndërtimi i disa amienteve të reja i tipit të klasave dhe laboratoreve

a) Faza e projekti zbatimit :

Ne kete faze, grupi i projektimit, ka perfunduar te gjithë projektin arkitektonik me cdo flete te nevojshme per zbatimin e punimeve per rikonstruksionin e objektit sipas kerkesave. Gjithashtu grupi i projektimit ka detajizuar te gjitha nderhyrjet qe paraqiten ne projekt dhe pamjet tredimensionale si do duket objekti pasi te perfundohet rikonstruksioni.

Grupi I projektimit ka kryer hartimin e Projekt - Zbatimit të objektit " Rikonstruksion Shkolla 9 - Vjeçare Ndroq" me përmbajtjen si më poshtë:

-
-
- Raporti Teknik
- Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
- Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
- Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtorja e Zjarrit dhe Shpëtimit
- Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut
- Analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve që nuk janë në manual;

- Plan organizimim e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;
- Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

- **Plani punes**

Eshte perpunuar një plan pune që paraqet rendin kronologjik të punimeve, ku të gjitha punimet formojnë një zinxhir aktivitetesh. Paraqitja e veprës do të realizohet nëpërmjet një grafiku sekuencial.

- **Kushtet Teknike**

Sa i takon Kushteve Teknike, projekti konsiston kryesisht në zhvillimin e aspekteve të mëposhtme:

--Përcaktimi dhe fusha e aplikimit

--Referenca e normativave në fuqi që do të zbatohet për ekzekutimin e veprës.

--Zhvillimi i specifikimeve që lidhen me normat teknike në fuqi të atyre neneve specifike që duhen zbatuar gjatë ekzekutimit të veprave, përmbajtja e të cilave jep një përcaktim të qartë të aktiviteteve, materialeve dhe/ose specifikime të ekipeve dhe/ose materialeve, kushtet e ekzekutimit dhe/ose instalimit, provave të marrjes, kushteve të volumeve dhe skontove.

Gjithashtu janë paraqitur variantet e ndërhyrjes, në bazë të rezultateve të vlerësimit të konstruksioneve mbajtëse, duke përfshirë dhe konceptimin e ndarjes së ambjentëve të brendëshme në varësi të funksionit të tyre me argumentimet përkatëse.

--Jane paraqitur variantet e propozuara me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse.

--Jane paraqitur variantet ide të sistemeve teknologjike dhe të tjera të përmendura në këtë detyrë projektimi.

--Jane paraqitur variantet e propozuara me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse.

IV .PERSHKRIM I ZONES KU DO NDERTOHEH OBJEKTI

4.1 PROBLEME MJEDISORE

Problemet kryesore mjedisore, që potencialisht mund të lindin gjatë fazës ndërtimore të objektit dhe me pas gjatë funksionimit të tij do të jenë:

Rrethimi i sheshit. Rrethimi i sheshit behet ne baze te kushteve teknike, ai do të jetë i rrethuar me llamarinë.

Prodhimi i pluhurave që mund të shoqërojnë ndërtimin që nga momenti i hapjes së themeleve dhe gjatë punimeve të mëvonshme.

Krijimi i zhurmave si rezultat i përdorimit të makinerive të rënda gërmues, transportuese, autobetoniereve, që do të përdoren gjatë ndërtimit të kësaj godine.

Mbeturinat ndërtimore si: dhera, mbeturina llaçi, tulla, gurë, inerte, gëlqere, armature etj.

Ngritja e infrastrukturës bazë urbane në plotësimin e nevojave për furnizimin normal me ujë dhe energji elektrike.

Shkarkimet e lëngëta si ujërat e bardha dhe të zeza nëpër kolektorët përkatës sipas studimeve të ndërmarrjeve përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve.

Largimi i mbeturinave urbane do të kryhet nëpër vende të caktuara sipas kërkesave të vëna nga Bashkia Tirane

Nevoja për rrjetin e telekomunikacionit do të plotësohet bazuar në bashkëpunimin reciprok me ndërmarrjet përkatëse.

Krijimi i hapësirave të gjelbërta në përfundim të punimeve për ndërtimin e objekteve

4.2 KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE

TEMPERATURA E AJRIT - Persa i perket luhatjes brenda vitit te temperatures se ajrit duhet thene se kemi te bejme me nje regjim tipik ku temperatura minimale vrojtohet ne muajin Janar, 6.9°C, ndersa temperatura maksimale vrojtohet ne muajt Korrik dhe Gusht 23.8°C.

Ne zonen tone, rendesi paraqesin gjithashtu edhe numri i diteve me temperature nen -10°C, qe quhen dite te akullta. Ne zonen ne te cilen shtrihet objekti ne studim, temperaturat nen -10°C jane teper te rralla.

Dite te ftohta ndodhin gjate periudhes se ftohte te vitit (Nentor-Mars) ku me te shquarit jane muajt Dhjetor dhe Janar, ndersa ditet me temperature nen -5°C jane shume te rralla dhe vetem nje dite eshte ne muajin Janar. Persa i perket temperaturave te ajrit duhet thene se zona ne studim karakterizohet nga nje klime e bute mesdhetare.

MJEGULLA - mesatarja vjetore me e madhe eshte 10.5 dite me mjegull ne Tirane-kjo eshte edhe me e madhja ne te gjithë Ultesiren Bregdetare-ku ne Shkoder eshte 6.1 dite dhe ne Vlore 1.5 dite ne vit. Ne pergjithesi ne muajt e stines se veres ne vendmatjen meteorologjike te vendit tone, mjegulla eshte nje dukuri e rralle. Rezulton se ne te gjithë zonen ne studim mjegulla zhvillohet pas mesit te nates, rreth ores 2 ose 3 dhe vazhdon deri ne oren 9-10 te mengjesit. Por nuk perjashtohen rastet kur mjegulla zhvillohet ne oret e mbremjes. Si rregull, ne muajt e periudhes se ngrohete te vitit, mjegulla zhvillohet rralle dhe ne qofte se ka raste qe zhvillohet nuk zgjat shume kohe, p.sh. ne Tirane kohezgjatje mesatare e mjegulles eshte 2 ore e 24 minuta. Kohezgjatja maksimale pa nderprejje e mjegulles ne Tirane eshte realizuar me 29 dhe 30 Janar 1968 per 11 ore e 43 minuta.

RRESHJET ATMOSFERIKE - Faktoret qe ndikojne ne karakteristikat e reshjeve atmosferike jane ne pozicionin gjeografik, afersia me detin dhe orografia. Objekti qe po studiojme shtrihet ne pjesen perendimore te vendit, ne Ultesiren bregdetare prane detit Adriatik me nje relief te ulet fushor dhe kodra qe e rrethojne nga perendimi dhe e mbrojne nga ererat bregdetare. Sasia e reshjeve vjetore eshte rreth 1200 mm. Sasia me e madhe e reshjeve ku jane regjistruar 1770mm dhe me e vogla 770 mm ne vit. Ne krahasim me vleren mesatare te territorit Shqiptar (140mm), kjo zone eshte me e ulet ne sasine e reshjeve atmosferike. Bora - Ne vendin tone, ne periudhen e ftohte te vitit, nje sasi e konsiderueshme e reshjeve vjen prej bores. Kjo veçori eshte me e theksuar ne zonen malore ku bora eshte nje dukuri e zakonshme. Ne zonen ne studim bora vrojtohet rralle dhe mund te konsiderohet si dukuri e jashtezakonshme. Numri me i madh i diteve me bore ne zonen ne studim eshte rreth 3 dite ne vit. Muaji Janar ka numrin me te madh te diteve me bore, duke u ndjekur nga Shkurti dhe Dhjetori. Krijohet rralle, por edhe kur krijohet, nuk mund te qendron gjate.

LAGESHTIA E AJRIT - Vlerat me te larta i takojne muajve Nentor, Dhjetor dhe Janar. Nderkaq vlerat me te uleta e lageshtires relative vrojtohen ne muajin Korrik dhe Gusht, pikerisht kur mbi rajonet e Mesdheut verehet nje qendrushmeria anti-ciklonare e theksuar. Ecuria ditore e lageshtires relative eshte e kundert me ate te temperatures se ajrit. Ne oret e para te mengjesit realizohen vlerat me te larta kurse ne oret e mesdites (para ose pas mesdites) vlerat me te uleta.

ERA - Shpejtesia e eres ne territorin e zones ne studim ashtu si ne te gjithë vendin tone, eshte ne vartesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te tyre vrojtohen ne stinen e dimrit kur veprimtaria ciklonare eshte e theksuar. Ne kete stine shpejtesite mesatare luhaten rreth 1.6 m/s

STUHITE - Stuhite qe per vendin tone jane te shumta dhe ndodhin ne te gjithë stinet e vitit, shpesh shoqerohen me breshër. Me shume dite me breshër ka ne muajt e dimrit dhe gjysmen e vjeshtes dhe ne gjysmen e pare te pranveres. Numri me i madh i diteve me breshër vrojtohet ne rrethin e Tiranës dhe Kamez. Tirana gjate viti ka 8 dite me bresheri. Si rregull, zgjatja e breshrit është 3 deri 5 minuta. Ne zonen ne studim, bresheri vrojtohet ne çdo kohe te vitit por me shume ne periudhen e ftohte te vitit. Gjate muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht nje dite me bresheri, Ne periudhen e ngrohte te vitit numri i diteve me breshër është i paket. Stuhite ne zonen ne studim mund te ndodhin ne çdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar qe ka klima e zones tone. Ne thelesi te territorit te Gadishullit Ballkanik gjate periudhes se ftohte te vitit (dimrit) stuhite pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental te klimes me ate rajon.

4.3 FLORA DHE FAUNA

Zona e projektit ka nje larmishmeri te habitatit shtazor, ku me poshte jete nje liste te plote te specieve te kafsheve te verejtura ne terren. Disa specie te vezhguara te gjarperinjve, zogjve, gjitareve te vegjel dhe amfibeve percaktohen ne Direktivat e BE per Habitatet e Flores dhe Faunes, Shtojca II dhe IV dhe ne Direktivat e BE per Zogjte.

GJITARET:

Lutra lutra (vidra e zakonshme)
 Plecotus auritus (lakuriqi veshgjate)
 Nyctalus noctula (lakuriqi i nates)

ZOGJTE:

Hippolais olivetorum (çafka e ullirit)
 Sylvia nisoria (çafke)

ZVARRANIKET:

Emys orbicularis (breshke e moçalit)
 Mauremys caspica (breshke e moçalit)
 Testudo hermannii (breshke mesdhetare e tokes)
 Natrix tessellata (gjarper)
 Lacerta trilineata (hardhuce e gjelber me tre vija)
 Lacerta viridis (hardhuce e gjelber)
 Podarcis taurica (hardhuce)

AMFIBET:

Rana lessonae (bretkose e vogel uji)
 Hyla arborea (zhabe peme)
 Triturus cristatus (salamander)
 Bufo viridis (zhabe e gjelber).

4.4 OBJEKTET ARKEOLOGJIKE DHE KULTURORE

Ne kete zone nuk takohen as objekte fetare dhe as objekte te cilat futen ne fondin e trashegimise kulturore dhe arkeologjike. Gjate gjithë konsultimit me literaturen dhe studime te kryera per kete zone, nuk jane gjetur objekte arkeologjike ose kulturore dhe nuk ka te dhena qe mund te ekzistojne. Sipas ligjit te Shqiperise, objektet fetare trajtohen si prone private, perveç kur ato zoterohen nga shteti.

4.5 CILESIA E AJRIT DHE NORMAT E TIJ

Ndotsit primare te prodhuar nga trafiku rrugor jane ato qe emetohen direkt ne atmosfere nga tubat e shkarkimit te automjeteve, te cilet jane dioksidi i karbonit (CO₂), monoksidi i karbonit (CO), hidrokarburet (HC), oksidet e azotit (NO_x), oksidet e sulfurit (SO_x), dhe grimcat.

Dioksidi i karbonit (CO₂) eshte gaz i ngrohjes globale dhe produkt natyral i djegies se benzines dhe naftes. Nuk ka impakt te drejtperdrejte ne shendetin e popullsesise rrethuese.

Perqendrimet e monoksidit te karbonit (CO) reduktojne aftesine metabolizuese te njeriut. Simptomat jane pergjumja dhe dhimbja e kokes. Per perqendrimet mbi 0.1 % mund te shkaktoje vdekje.

Keto nivele nuk shkaktohen nga trafiku dhe perqendrimet ne hapsirat rurale jane probleme te rralla. Njerezit e ekspozuar ne CO mund te sherohen duke u larguar nga vendi i ndotur.

Monoksidi i karbonit (CO) eshte problem i veçante per tregtarët, per ata qe punojne per nje kohe te gjate ne ane te rrugeve te mbi populluara, te cilat jane te rrethuara me pallate duke krijuar efektin kanion, i cili perqendron ndotesit ne lartesi te vogla.

Ndotsit sekondare krijohen nga dy ndotes primare, HC dhe NO_x dhe si rezultat i reaksioneve fotokimike prodhohen oksidues si ozoni (O₃), peroksacetyl nitrati (PAN) dhe peroksibenzol nitrati (PBN). Keto oksidues ne perqendrimet te larta mund te kene nje efekt te gjere ne shendet dhe vegjetacion. Standartet e cilesise se ajrit ne Shqiperi tregohen ne tabelat me poshte.

Tabela . Standartet ne Shqiperi per cilesine e ajrit ne hapesirat urbane

(Ne kuptim te ketij vendimi ne normat e cilesise se ajrit nuk perfshihen normal e mjediseve te brendshme te banimit dhe te punes)

Nr. Rendor	NDOTESI	VLERAT E STANDARDIT	TIPI I STANDARDIT
1. Monoksid karboni (CO)			
	Mesatare 24-orësh****	2 mg/m ³	Primar *
	Mesatare 8-orësh	10 mg/m ³	Primar
	Mesatare 1-orësh	40 mg/m ³	Primar
2. Bioksid azoti (NO ₂)			

Mesatare vjetore arithmetike*** 60 µg/m3 Primar &	60 µg/m3	Primar & Sekondar **
Mesatare 4-oresh	95 µg/m3	Sekondar
Mesatare 1-oresh	250 µg/m3	Primar
4. Plumb (Pb)		
Mesatare vjetore arithmetike	1.0 µg/m3	Primar & Sekondar
Mesatare 24-oresh****	1.5 µg/m3	Primar & Sekondar
5. Lende e grimcuar e depozituar (LGD)		
Mesatare vjetore arithmetike	350 mg/m2/dite	Primar & Sekondar
(Koha e matjes 1 muaj)		
6. Lende e grimcuar pezull (LGP)		
Mesatare vjetore arithmetike	140 µg/m3	Primar & Sekondar
Mesatare 24-oresh	250 µg/m3	Primar & Sekondar
7. Lende e grimcuar < 10 mikrometer (PM 10)		
Mesatare vjetore arithmetike	60 µg/m3	Primar & Sekondar
Mesatare 24-oresh	150 µg/m3	Primar & Sekondar

8. Lende e grimcuar < 2.5 mikrometer (PM 2.5)		
Mesatare vjetore arithmetike	15 µg/m3	Primar & Sekondar
Mesatare 24-oresh	66 µg/m3	Primar & Sekondar
9. Bioksid squfuri (SO2)		
Mesatare vjetore arithmetike	60 µg/m3	Primar
Mesatare vjetore arithmetike	35 µg/m3	Sekondar
Mesatare 24-oresh	120 µg/m3	Primar

Standardet primare jane kufij qe sherbejne per te mbrojtur shendetin e popullatave "te ndjeshme" si azmatiket, femijet dhe pleqte.

**Standardet sekondare jane kufij qe sherbejne per te mbrojtur mireqenien publike, duke perfshire mbrojtjen kundrejt uljes se pamjes, demtimit te kafsheve, te mbjellave, bimesise dhe ndertesave.

4.6 ZHURMAT

Pranimi i nje niveli te caktuar zhurmash varion nga lagjet, individet dhe periudha e dites. Zhurma influencen ne te gjitha aktivitetet, por problem te veçante perben per zonat e ndjeshme. Hapesirat e banuara ndikohen zakonisht gjate oreve te nates dhe ne pasditen e vone (7.00 gjate veres dhe 6.00 gjate dimrit), sepse eshte orar studimi per shkollaret.

Zhurma bashke me trafikun rrugor zakonisht konsiderohet te jete pak a shume ne nje nivel konstant, ndonese kjo ndoshta nuk eshte nje paraqitje e drejte e zhurmave te lindura nga trafiku aktual ne seksionin rrugor qe perfshin projekti.

Zakonisht si njesi per te matur zhurmat perdoret decibeli (dB). Diferenca me e vogel e nivelit te zhurmes qe arrin ta perceptoje veshi i njeriut eshte afersisht 3 dB. "A" eshte nje koeficient me ane te te cilit, frekuencave te larta u jepet nje ngarkese ekstra.

Nje matje e niveleve te zhurmave eshte Leq. Leq eshte niveli ekuivalent konstant, i cili me kalimin e kohes permban te njejten sasi te energjise se tingullit sa eshte niveli i ndryshueshem i zhurmave te trafikut. Standartet e zhurmave te ambjenteve te ndyshme jane zhvilluar, megjithese asnje ne Shqiperi. Banka Boterore ka perpunuar vlerat per tipe te ndryshme hapesirash dhe jane te paraqitura ne tabelen me poshte. Keto tregojne nivelet me te larta te tolerueshme gjate nates dhe dites.

4.7 GJEOLGJIA DHE HIDROGJEOLGJIA

Nuk eshte bere studim gjeologjik pasi nderhyrjet jane te plesshme.

V. NDIKIMET NE MJEDIS GJATE KOHES SE FUNKSIONIMIT

5.1 ANALIZA E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Veprimtaria qe propozohet ka permasa relativisht te vogla persa i perket aktiviteteve ndertimore pasi shfrytazon nje godine ekzistuese. Ky kapitull do te paraqese nje analize te hollesishme te ndikimeve te mundshme duke specifikuar edhe masat zbutese qe do te perdoren per te eliminuar apo per te minimizuar ndikimet ne mjedis.

Ndikimet ne mjedis mund te grupohen si me poshte:

Kimike-Fizike te cilat lidhen me ndikimet mbi burimeve natyrore si edhe proceset e degradimit fizik te mjedisit vete;

Biologjike-Ekologjike perfshire burimet e energjive te rinovueshme, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jeten e gjalle te ndotjes se biosferes;

Ndotje per shkak te rrezatimit, pasi disa prej metodave te imazherise kane ndikime te tilla;

5.2 CILESIA E AJRIT

Cilesia lokale e ajrit zakonisht priset nga ndertimi. Pakesimi i ndotjeve ne cilesine e ajrit mund te minimizohet pas perfundimit te objektit. Prodhimi i pluhrave te cilat do te shoqerojne ndertimin, si ne momentin e hapjes se themelit e deri tek ngarkimi i inerteve per ndertim, parashikohet te mos kete nje ndikim te ndjeshem ne cilesine e ajrit.

Per shkak te vete natyres se punes se ndertimi eshte normale qe te prodhohet nje nivel i larte zhurmash. Megjithate ndikimi per shkak te veprimtarise ndertuese do te jete me natyre kalimtare.

Ky paragraf analizon ndikimet ne cilesine ajrit qe burojne duke marre ne konsiderat fazen funksionale te veprimtarise. Emetimet ne ajer perfaqesohen vetem nga gazrat e çliruara nga automjetet qe leshojne dyoksid karboni (CO₂) dhe nje perberje te pakte te oksidit te azotit (NO). Shperndarja e pluhrit PM10 ne atmosfere do jete si rezultat i levizjes te makinave qe do te perdoren gjate ndertimi

5.3 SHESHI I NDERTIMIT

Rrethimi i sheshit te ndertimit do te behet me llamarina ne te gjithë perimetrin e tij, duke lene nje hyrje e cila do te shfrytëzohet per te hyre ne sheshin e ndertimit me qellim germimin si dhe punimet e tjera ne perputhje me grafikun e punimeve.

5.4 MBETJET GJATE NDERTIMIT

Ndikimet ne toke si te tilla do te jene ne pergjithesi te kufizuara.

Mbeturina ndertimore si dherat, mbeturina llaçi, tulla, gure, inerte, gelaqere, armature derrase etj. do te hidhen ne nje vend te caktuar nga Bashkia e Tirane dhe jo jashte rrethimit te ndertimit.

5.5 MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Permbledhja e matricës paraqet ndikimet gjate kohës së funksionimit të veprimtarisë. Zhurmat të cilat janë shënuar me ndikim negativ shumë të vogël është si pasojë e rritjes të përqendrimit të makinave në atë zonë për shkak të vizitave dhe në raste urgjence.

Ndikimet në Mjedis	Gjate funksionimit
Ajri	-
Ujërë të sipërfaqësore	-
Ujërë të nëntokësore	-
Mbetjet Urbane	-
Zhurmat	- +
Pejsazh	-

5.6 KLIMA

Pasojat e projektit mbi klimën nuk do të jenë të rëndësishme. Si gjatë fazës së ndërtimit ashtu dhe gjatë shfrytëzimit nuk do të jetë e nevojshme të merren masa përmirësuese.

5.7 FLORA DHE FAUNA

Për më tepër aktiviteti gjatë ndërtimit dhe depozitimi i materialeve mund të krijojnë efekte në florën dhe faunën e zonës.

5.8 DRENAZHIMI

Shkarkimet e lëngjeve si ujërat e bardha dhe ato të zeza do të behen nëpër pusetat përkatëse.

5.9 TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE DHE KULTURORE

Përsa i takon ndikimit në prizmin negativ në mjediset e trashëgimisë arkeologjike dhe kulturore të kësaj zone paraqitet kërcënim për shkatërrimin e mbetjeve arkeologjike.

Ndërsa ndikimi pozitiv është më i rëndësishëm dhe konsiston në vlerësimin e mundshëm dhe përfshirjen e kësaj trashëgimie në zhvillimin e ardhshëm të kësaj zone.

Në rast se do të zbulohen objekte me rëndësi të madhe arkeologjike apo kulturore atëherë do të duhet të behet dhe ndryshimi i projektit.

VI. MASAT DHE PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit është në planin e organizimit të punës, shoqëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedisin përreth zonës së saj.

Transportimi i materialeve që nevojiten do të programohet me kujdes për të shmangur çdo shqetësim në trafikun lokal. Do të vendosen tabela orientuese për parkimin e automjeteve duke shmangur trafikun dhe aksidentet e mundshme.

Menaxhim sa me eficient te energjise elektrike, duke perdorur llamba ekonomike. Perdorimi i mekanizmave automatic per mbylljen e dyerve. Instalimi i impianteve qendrore te ngrohjes ftohjes dhe ajerimit te cilat do monitorohen vazhdimisht.

Pastrimi periodik i rugeve hyrese te lidhura me rrugen kryesore. Ne zonen perreth hap pas hapi parashikohet sistemimi dhe zhvillimi i bimesise dekoruese. Masat estetike dhe ekologjike jane parashikuar duke krijuar kushte te pershtatshme per mbjelljen e pemeve te ndryshme lokale. Do te instalohet sistem i ujitjes se tyre dhe per mjedisin e shoqerise.

Investitori do te jete gjithmone i hapur per te bashkpunuar me institucionet e ruajtjes dhe mbrojtjes se mjedisit te cilat do te monitorojne aktivitetin e tij me qellim eleminimin e çdo impakti negativ ne mjedis.

6.1 NDOTJA E AJRIT DHE ZHURMAT

Aktivitetet ndertuese shkaktojne shperndarjen e pluhurave ne atmosfere dhe uljen e cilesise se ajrit ne zone. Duhet te adoptohen masat e meposhteme ne menyre qe te lehtesohet ky ndikim:

- Sperktaja me uje per te kufizuar çlirimin e pluhurave ne zonat prane materialeve te ndertimit.
- Mbulimin e siperfaqeve me mbulues plastike gjate magazinimit dhe transportimit te materialeve.
- Mbjelljen e pemeve prane sheshit te ndertimit.
- Pastrimi periodik i sheshit te ndertimit dhe rruges hyrese.
- Perdorimin me efikasitet te makinerive moderne te ndertimit per te minimizuar ndotjen.
- Rrjetat mbrojtese per minimizimin e pluhurave do te perdoren ne perfundim te karabinase.
- Paisjet zhurmuese do te ndalohen te perdoren nga 22.00-6.00 çdo dite.

6.2 BIODIVERSITETI

Zona perkohesisht e zene nga projekti do te rikultivohet dhe rehabilitohet menjehere pas ndertimit.

6.3 SHFRYTEZIMI I TOKES

Materialet e mbetjeve do te hidhen ne vende te parashikuara nga Bashkia Tirane

6.4 TRASHEGIMIA ARKEOLOGJIKE DHE KULTURORE

Ne rast se gjate germimeve do gjenden mbetje arkeologjike, punimet menjehere do te ndalen, askush nuk do te lejohet te levizi apo te heqe ndonje objekte dhe menjehere do te informohen autoritet lokal kompetentet. Punimet do te rifillojne vetem pas te jene marre masat e duhura ashtu siç kerkohen nga autoritetet kopetente dhe pasi te jete konfirmuar prej tyre se punimet mund te fillojne normalisht

VII. KONKLUZIONE

Nga kjo VNM arriem keto perfundime:

- Identifikimin e te gjitha ndikimeve, sidomos ato negative

- Identifikimin e menyrove alternative per projektin qe pason
- Ofruam modele metodash lehesisht te zbatueshme
- Reduktim te impaktit mjedisor
- Reduktim te impaktit social
- Reduktim te strukturave/objekteve qe prekeshin nga projekti

Nga ky Raport nxjerrim konkluzionin se Ndikimet negative jane te papefillshme ne krahasim me rendesine qe ka rikonstruksioni i kesaj shkolle..

Ne kete vleresim garantojme nje projekt lehtesisht te zbatueshem dhe te menaxhueshem nga investitori.

Rekomandime:

- Te bashkepunohe me autoritetet perkatese, se cila do te jete menyra e trajtimit perfundimtar te mbetjeve te tjera qe nuk jane te perfshira ne kontraten e sherbimit.
- Te mbahen kontakte te vazhdueshme me komunitetin
- Te behet trajnime per punonjesit dhe nenkontraktoret te objektit, per njohjen e praktikave me te mira te ruajtjes se mjedisit.
- Te respektoj te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve dhe ARM-se te qarkut Tirane.
- Te realizoje mbjedhjen e pemeve dhe gjelberim perreth shkolles dhe vendparkimin per punonjesit.